V E N D I M
Nr. 115, datë 6.6.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar	i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar	i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar	i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar	i “ “
Kujtim Puto	Anëtar	i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar	i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar	i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 19.4.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 80 Akti që i përket:

KËRKUES: AGRON VRETO, përfaqësuar nga avokate Hanëme Bakia.
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. SOKOL MARA, përfaqësur nga avokat Dashamir Kore, me prokurë.
2. SUZANA MARA, përfaqësuar nga avokat Dashamir Kore, me prokurë.
3. NDËRMARRJA KOMUNALE BANESA NR.2 TIRANË, përfaqësuar nga Florenca Demneri, me autorizim.
OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetutes i vendimeve nr. 1234, datë 15.12.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe nr. 12, datë 10.1.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se vendimet e sipërcituara janë antikushtetuese, pasi i kanë shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar këto shkaqe:
- Në përbërje të trupit gjykues në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, ka marrë pjesë i njëjti gjyqtar, i cili, kur kjo çështje është shqyrtuar nga kjo Gjykatë më parë, ka shprehur mendim për themelimin e çështjes, të arsyetuar me shkrim në një mendim pakice. Pjesëmarjen e të njëjtit gjyqtar të Gjykatës së Lartë në këtë proces kërkuesi e konsideron shkelje të nenit 72/4 të Kodit të Procedurës Civile dhe cenim të parimit të paanësisë në gjykim.

- Gjykata e Apelit të Tiranës nuk ka respektuar detyrat e dhëna nga Gjykata e Lartë, duke shkelur kërkesat e nenit 486 të Kodit të Procedurës Civile. Dhënia e vendimit nga gjykata e apelit, në kundërshtim me detyrat e caktuara nga Gjykata e Lartë, si dhe me ligjin material, janë rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor.
- Në rekurs janë ngritur shkaqe ligjore, por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka shkelur kërkesat e nenit 472 shkronja “a” dhe “b”, duke vendosur mospranimin e rekursit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesen e kërkuesit, përfaqësuesin e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në shqyrtimin e kësaj çështjeje, mendimet e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese u ndanë në një mënyrë që nuk arrihej të votohej asnjë përfundim i çështjes. Arsyeja kryesore lidhet me përbërjen e saj që në këtë çështje nuk ishte e plotë.
Në këto kushte, meqënëse votat e anëtarëve u ndanë në mënyrë të barabartë, gjë që ndikon në

mosmarrjen e një vendimi përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese dhe duke qenë se ekziston mundësia që në të ardhmen me plotësimin e numrit të nevojshëm të vendimmarrjes së Gjykatës kjo çështje mund të rishqyrtohet përsëri, kërkesa duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f dhe 132 të Kushtetutës, si dhe nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I :

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.